



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

**RREGULLORE**

**“PËR PËRCAKTIMIN E MASAVE PËR KUFIZIMIN E PËRHAPJES SË  
COVID-19”**



**GJATË USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË ZYRËS SË  
”KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI”**

**Tiranë 2020**

## **Neni 1**

### **Baza Ligjore**

Kjo rregullore hartohet dhe miratohet në bazë të ligjit nr.10221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenit 42 të ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, ligjit nr.15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, urdhërit nr.156, datë 10.03.2020 “Për marrjen e masave të vecanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga Covid 19”, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Sociale.

## **Neni 2**

### **Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe praktikave të duhura, nisur nga situata në të cilën ndodhet vendi për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga COVID-19, për kufizimin e përhapjes së këtij infeksioni, duke mbikëqyrur zbatimin e planit të masave organizative dhe administrative, gjatë vijimit të veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

## **Neni 3**

### **Përkufizime**

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. Sëmundja koronavirus 2019 (COVID-19) - është një sëmundje infektive e shkaktuar nga sindromi i rëndë akut i frymëmarrjes koronavirus 2 (SARS-CoV-2);
2. KMD - është Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
3. Punonjës - është çdo anëtar i stafit administrativ;
4. Struktura përgjegjëse – është Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse ;
5. NJVKSH – është Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor në qarkun e Tiranës;
6. ISHP – Instituti i Shëndetit Publik.

## **Neni 4**

### **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të sigurojë dhe orientojë punonjësit mbi:

1. Reduktimin e transmetimit dhe parandalimit të përhapjes së infeksionit COVID-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë së KMD-së.
2. Sigurimin e një ambjenti të shëndetshëm në punë të punonjësve të KMD-së.
3. Vijmësinë normale të veprimtarisë së institucionit.

## **Neni 5**

### **Masat e përgjithshme të higjienës dhe të distancimit social në institucion**

1. Në ambientet e KMD-së duhet të sigurohet në mënyrë të vazhdueshme përdorimi i produkteve të higjienës, ku përfshihen sapun i duarve, dezinfektantët me bazë alkooli që kanë të paktën 60% alkool, letër apo peceta për pastrimin e duarve ose peshqir, letra dhe dezinfektante për pastrimin e sipërfaqeve. Koshat për hedhjen e mbeturinave në çdo zyrë duhet të pajisen me qese të cilat duhet të ndërrohen përditë në fund të ditës së punës.
2. Punonjësit duhet t'i sigurohet në mënyrë të vazhdueshme pajisja me mjetet mbrojtëse personale si maska dhe doreza njëpërdorimshe, të cilat duhet të ndërrohen çdo ditë. Përdorimi i maskave dhe dorezave shërben si barrierë fizike për minimizimin/kufizimin e transmetimit të infeksionit COVID-19.
3. Në ambientet e punës duhet të praktikohet pastrimi i vazhdueshëm i sipërfaqeve dhe elementëve të tjerë të vendit të punës si p.sh: tavolinat e punës, tastierat, telefonat, parmakët dhe dorezat. Produktet dezinfektante që përdoren për pastrim, të kenë përqindjen e alkoolit sipas pikës 1 të këtij neni, metodën e aplikimit dhe kohën e kontaktit të saktë. Në çdo rast përdorimi i tyre bëhet duke përdorur mjetet e mbrojtjes personale.
4. Në rast se sipërfaqet në vendin e punës janë të ndotura, duhet të pastrohen duke përdorur një pastrues ose sapun dhe ujë, para dezinfektimit.
5. Për shmangien e përhapjes së infeksionit në ambientet e punës së KMD-së nga persona që nuk janë pjesë e stafit të institucionit, në ambientin hyrës duhet të vendoset një dezinfektant me bazë alkooli që përmban të paktën 60-95% alkool, i dedikuar vetëm për këta persona. Përdorimi i tij është i detyrueshëm për të patur akses në ambientet e tjera.
6. Çdo qytetar që futet në ambientet e institucionit duhet të jetë i pajisur me mjetet mbrojtëse personale si maska dhe doreza njëpërdorimshe.

## **Neni 6**

### **Zbatimi i masave**

Çdo subjekt duhet të respektojë masat e mësipërme të rekomanduara nga ISHP nëpërmjet një plani individual veprimi duke respektuar çdo element për kufizimin e transmetimit të COVID-19 tek punonjësit brenda ambienteve të Zyrës së KMD-së.

## **Neni 7**

### **Detyrimet e strukturës përgjegjëse**

1. Struktura përgjegjëse, për krijimin e kushteve dhe monitorimin e zbatimit, të kësaj Rregulloreje është Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.
2. Struktura përgjegjëse duhet të parashikojë një plan masash për të siguruar distancimin social dhe, nëse kapaciteti i punonjësve kalon normën e lejuar për sipërfaqe në m<sup>2</sup> duke respektuar distancën fizike 2 m, pas këshillimit me strukturat e tjera të institucionit, duhet të hartojë një politikë të brendshme për organizimin e punës, e cila do të përfshijë:

- a) Zbatimin e vendeve të punës fleksibël (p.sh. punë në distancë);
  - b) Zbatimin e orëve fleksibël të punës (p.sh. ndërrime të orarit të punës/ditëve të punës);
  - c) Rritjen e hapësirës fizike midis punonjësve në vendin e punës; (p.sh.përmes distancës);
  - d) Rritjen e hapësirës fizike midis punonjësve dhe qytetarëve (p.sh. përmes distancës);
  - e) Zbatimin e opsioneve fleksibël të takimit dhe udhëtimit (p.sh.shtyrja e takimeve ose ngjarjeve jo thelbësore);
  - f) Pezulli i seancave dëgjimore dhe marrjes së ankesave në ambientet e KMD-së ;
  - g) Mundësimin e komunikimeve apo kryerjen e detyrave në distancë (p.sh. telefon, video ose email).
  - gj) Evidentimin e rasteve të nëpunësive/punonjësve me patologji të ndryshme, të cilët janë më të rrezikuar në rast infektimi nga COVID-19;
  - h) Evidentimin e nëpunësive/punonjësve që kanë në kujdestari fëmijë deri në moshën 14-vjeç. Për rastet e parashikuara në shkronjat “g” dhe “h” , të kësaj pike, përpara miratimit të grafikut,institucionet duhet të konsultohen me nëpunësit/punonjësit me qëllim që të mundësohet realizimi i detyrave dhe për t’u përshatur me kërkesat e tyre.
3. Struktura përgjegjëse duhet të vendosë elementët e distancimit fizik. Rrregullorja mbi masat e kufizimit për përhapjen e COVID-19 duhet të jetë e publikuar në faqen zyrtare, www.kmd.al të informohen të gjithë punonjësit apo të publikohet në mënyrë sa më të dukshme.
  4. Struktura përgjegjëse, përpara se të hyjë në institucion çdo punonjës apo qytetar, duhet t’ë kontrollojë temperaturën dhe më pas të lejohet ose jo hyrja në institucion.
  5. Struktura përgjegjëse duhet të monitorojë nëpërmjet sistemit të kamerave të brendshme të instaluara nëse masat e përcaktuara të higjienës dhe kujdesit zbatohen me përpikmëri.
  6. Struktura përgjegjëse për aq sa është e mundur duhet të përmirësojë kontrollet inxhinierike duke përdorur sistemin e ventilimit të ndërtesave. Kjo mund të përfshijë disa ose të gjitha aktivitetet e mëposhtme:
    - a. Rritjen e niveleve të ventilimit;
    - b. Rritjen e përqindjes së ajrit në natyrë që qarkullon në system
  7. Në ambientet e KMD-së duhet të ketë një mjedis të caktuar për të izoluar një punonjës, i cili mund të shfaqë shenja klinike të sëmundjes dhe më pas lajmërohet nr tel.127-ta dhe NJVKSH-ja përkatëse.

## **Neni 8**

### **Detyrimet e punonjësit**

1. Punonjësi, me qëllim ruajtjen e shëndetit vetjak dhe të kolegëve, duhet të kujdeset që të zbatojë me përpikmëri të gjitha rregullat e parashikuara në këtë rregullore.
2. Punonjësi është i detyruar të deklarojë pranë strukturës përgjegjëse nëse ka pasur kontakt me persona të cilët rezultojnë të jenë të infektuar me Covid-19. Në rast se punonjësi ka pasur apo ka kontakt të ngushtë me një person me Covid-19, duhet të qëndrojë në vetëkarantinim dhe të njoftojë menjëherë strukturën përgjegjëse, e cila më pas njofton Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor përkatëse.

3. Punonjësi nuk duhet të përdorë telefonat, tavolinat, zyrat ose mjetet dhe pajisjet e punonjësve të tjerë, kur është e mundur. Nëse është e nevojshme, ato duhet të pastrohen ose dezinfektohen para dhe pas përdorimit.
4. Punonjësi duhet të përdorë mjetet e mbrojtjes personale si maska dhe doreza si dhe duhet të lajë shpesh duart me ujë dhe sapun ose pastrojë ato duke i fërkuar me pastrues me bazë alkooli (*me përqindjen e alkoolit siç është përcaktuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje*)
5. Maska duhet të vendoset në mënyrë të tillë që të mbulojë plotësisht fytyrën nga maja e hundës deri tek mjekra dhe duhet të hiqet duke e kapur vetëm tek pjesa e lidhëseve anësore dhe jo tek pjesa e përparme.
6. Dorezat duhen hequr në mënyrë të tillë që duart të mos prekin sipërfaqen e jashtme të tyre dhe të hidhen menjëherë në koshin e mbeturinave. Punonjësi duhet të lajë duart ose të përdorë dezinfektant (*me përqindjen e alkoolit siç është përcaktuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje*) pas heqjes së dorezave.
7. Punonjësi nuk duhet të përdorë shtrëngimin e duarve por metoda të tjera jokontaktuese të përshëndetjes.
8. Punonjësi duhet të evitojë kontaktin fizik si formë përshëndetje dhe të ruajë distancimin fizik gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij prej së paku 2 (dy) m. me kolegët apo persona të tjerë.
9. Punonjësi duhet të respektojë praktikatat e etikës respiratore, kollitjes e tështitjes nëpërmjet vënies së gropëzës së bërrylit përpara gojës dhe hundës, ose shami letre. Shamia e letrës pas përdorimit duhet hedhur në koshin e mbeturinave dhe menjëherë më pas duhen larë duart.

## **Neni 9**

### **Dispozitat e fundit**

Dispozitat e kësaj rregulloreje janë të detyrueshme për njohje dhe zbatim nga i gjithë personeli i KMD –së, duke i vënë çdo punonjësi, në dispozicion një kopje të saj.

Kjo rregullore është e vlefshme deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 dhe mund plotësohet ose ndryshohet në raport me vijueshmërinë e saj.

Ngarkohet për zbatimin e kësaj rregulloreje struktura përgjegjëse e KMD-së.

## **Neni 10**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.